



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Këshilli Drejtues: PhD.Can. Agron Hajdari, Kryesues i KD Ref.nr. Q2/2750 / 30 / 11 /2021

Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2021, mori vendim të shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2020/21

I. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të rregullt;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. Të mos kenë vit të përsëritur;
4. Të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit.

II. Studentët duhet plotësuar edhe kriteret shtesë të aprovuara nga KD dhe atë:

- Studentët e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik dhe Fakulteti Juridik si dhe programet master: E-Qeverisje dhe QLSHD (Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike) duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00;
- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Shkencave Aplikative duhet të kenë notën mesatare më së paku 8.50.

III. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I dhe pika II e konkursit duhet të paraqesin këto dokumente:

- Formularin e plotësuar (shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e universitetit);
- Vërtetimin për statusin e studentit (lëshohet nga fakulteti);
- Pasqyrën e provimeve të dhëna (lëshohet nga fakulteti).

IV. Afatet e konkursit

- Aplikimi për bursë universitare bëhet nga datat 01.12.2021 deri më 06.12.2021 ora 15:00.
- Dorëzimi i dokumenteve bëhet në fakultetin përkatës.

